

TË JETOSH NË ITALI. ITALISHTJA PËR PUNËN DHE NËNSHTETËSINË – VITI I KATËRT 2014/2015

AL

FINANCUAR NGA	Ministria e Brendshme me fondet europiane FEI (Fondi European për Integrimin e Shtetasve të Vendeve të Treta).
DREJTUES	Rajoni i Lombardi-së (Drejtoria e Familjes, Solidaritetit Social dhe Aktiviteve Vullnetare).
PERIUDHA	2014 - 2015
OBJEKTIVAT	Të mbështesë integrimin gjuhësor dhe shoqëror të qytetarëve të huaj, duke i dhënë prioritet të porsardhurve në Itali që kanë nënshkruar Akordin e Integritit.
AKTIVITETET	Kurse të gjuhës italishte me kohëzgjatje e nivele të ndryshme në të gjitha provincat e lombardisë duke filluar nga niveli përgatitës për A1 deri tek A2.
KURSET	<ul style="list-style-type: none">• Niveli pre A1 me 100 orë për personat të cilët nuk njohin gjuhën italiane dhe të pa arsimuar ose me nivel të ulët arsimimi në gjuhën amtare.• Niveli A1 me 100 orë.• Niveli A2 me 80 orë.• Intensiv me 180 orë.• Kurse gjuhe më të shkurtër (nga 40 deri në 60 orë) për qytetarët që kanë njohuri fillestare të gjuhës italiane.

INFORMACIONE PËR KURSET

- Të gjitha kurset parashikojnë një periudhë **njohjeje reciproke**, për ti dhënë mundësi mësuesve të njohin studentët e kurseve dhe të zgjedhin së bashku kursin më të përshtatshëm lidhur me kompetencat dhe ekzgjencat e secilit ndërmjet kurseve të organizuar në territor.
- Të gjitha kurset e nivelit A2 të realizuar nga projekti.
- “Të jetosh në Itali” në bazë të një marrëveshjen ndërmjet partnerëve ju lëshojnë një certifikatë të vlefshme per Akordin e Integritimit.
- Të gjitha kurset ju lëshojnë një certifikatë frekuentimi.
- Në të gjithë kurset do të trajtohen temat e formimit qytetar.
- Disa kurse janë programuar për punonjësit dhe parashikojnë orientim, bilanc të kompetencave profesionale dhe sigurisë në punë.
- Në disa kurse, për të lehtësuar pjesmarrjen e nënave me fëmijë të vegjël, parashikohet prezenca e një shërbimi me **kujdestare për të vegjëlit**.



KUJDES!

Niveli A2 i gjuhës italiane është niveli i parashikuar nga ligji për tu pajisur me LEJEQENDRIMI AFATGJATË QENDRIMI NE K.E; për Akordin e Integritimit duhet që brenda dy vjetësh nga firma, qytetari të zotërojë nivelin A2 të gjuhës së folur.

PËR TË PASUR MË SHUMË NJOHURI

SPORTELL INFORMACIONI NËPËRMJET TELEFONIT

Sportell i informacionit nëpërmjet një shërbimi telefonik shumëgjuhësh, realizuar nën kujdesin e kooperativës Progetto Integrazione, është një shërbim telefonik falas, që funksionon nga e hëna deri të premtën.

Kur telefononi tek numri i gjelbër **800 513 340**, përgjigjet një ndërmjetës kulturor, i cili në gjuhën amtare ose në italisht ju ofron informacione mbi:

- kurset e gjuhës italiane, orientim për punësim të realizuara nga partnerët e projektit Të jetosh në Itali;
- Akordit të Integritimit;
- provat e nivelit A2 për lejeqëndrimin afatgjatë;
- procedura e parashikuar për njohjen e titujvë të studimit të lëshuara jashtë Italisë;
- informacione të tjera të nevojshme për qytetarët që jetojnë në Itali.

E HËNË	14.00-18.00 italisht, inglisht dhe tagalog
E MARTË	10.00-13.00 italisht, shqipe
E MARTË	14.00-18.00 italisht, urdu
E MËRKURË	10.00-13.00 italisht, arabisht e frengjisht
E MËRKURË	14.00-18.00 italisht dhe në gjuhën kineze
E ENJTE	14.00-18.00 italisht, rumanisht (për qytetarët nga Moldavia)
E PREMTE	14.00-18.00 italisht, spanjisht

Gjithashtu mund të merrni kontakt:

- nëpërmjet mailit: **info@telefonomondo.it**
- faksit: **02/67574334**

Nërmjet sitit internet të projektit www.vivereinitalia.eu mund të gjeni informacione mbi kurset, adresat e nevojshme materiale didaktike edhe për formim autodidakt.

BAZAT LIGJORE

Ju sjellim më poshtëmë informacione të nevojshme mbi ligjet për hyrjen në Itali dhe lejeqëndrimin.

DPR I DATES 28 KORRIK 2011: AKORDI I INTEGRIMIT NDERMJET QYTETARIT TE HUAJ DHE SHTETIT

Në bazë të Dekretit të marsit 2012, qytetarët e huaj të moshës mbi 16 vjeç që paraqiten në Sportelin e Përgjithshëm (Sportello Unico) për të bërë kërkesën për lejen e qëndrimit duhet të nënshkruajnë **Akordin e Integrimit** me shtetin.

Akordi është i ndarë me kredite dhe parashikon që qytetari i huaj të ndjekë një kurs të formimit qytetar (aktualisht prej 10 orësh) brënda tre muajsh nga hyrja në Itali dhe njohuritë bazë të gjuhës italiane (niveli A2 gjuha e folur) brënda dy vjetësh. Gjithashtu shtetasi i huaj duhet të garantojë përbushjen e arsimit të detyruar për fëmijët e mitur, duhet të zbatojë Kartën e vlerave të nënshtetësisë dhe integrimit, duke u përkushtuar të respektojë parimet.

Në fillim, të gjithëve u caktohen 16 kredite, por për të arritur Akordin duhet të arrihen 30 kredite brënda 2 vjetësh. Kreditet shtohen përmes fitimit të njohurive të caktuara (p.sh.: njohja e gjuhës italiane, e kulturës qytetare dhe jetës civile në Itali) dhe zhvillimi i aktiviteteve të caktuara (p.sh.: periudhat e arsimit dhe formimit profesional, ndjekjen e titujve të studimit, regjistrimin pranë shërbimit kombëtar shëndetësor, aktiviteteve vullnetare etj).

Akordi zgjat dy vjet, por afati mund të shtyhet. Nuk i nënshtrohen kësaj marrëveshjeje personat

me sëmundje të rënda ose me aftësi të kufizuara, viktimat e trafikut njerëzor, viktimat e dhunës ose shfrytëzimit të rëndë (për ta marrëveshja zëvendësohet me përmbushjen e periudhës së mbrojtjes sociale).

KUJDES!

Shtetasi i huaj që brenda 3 muajsh nga mbërritja e tij nuk frekuenton kurset falas të formimit qytetar, mund të humbasë 15 kredite.

Të gjitha kreditet e caktuara ose të hequra administrohen nga një zyrë kombëtare regjistrimi, pranë së cilës personat e interesuar mund të kontrollojnë kreditet e tyre (www.portaleimmigrazione.it).

D. M. I DATËS 4 QERSHOR 2010: LEJEQENDRIMI AFATGJATË E QENDRIMIT NE K.E.

Leja afatgjatë e qëndrimit në KE është një lejeqëndrim me afat të pakufizuar. Kërkesa bëhet pranë zyrave postare, duke plotësuar formularët përkatës. Për sqarime dhe ndihmë të mëtejshme mund të drejtoheni pranë Komunave dhe Patronateve. Leje afatgjatë qëndrimi në KE mund të kërkojë personi që:

- **ka leje qëndrimi dhe jeton me rregulla në Itali prej të paktën 5 vjetësh;**
- ka të ardhura jo më pak se € 5.818,93 për vitin 2014;
- jeton në një shtëpi të përshtatshme (me certifikatë të lëshuar nga komuna ose nga **ASL** për kushtet higjienike të përshtatshme);
- vërteton se njih gjuhën italiane në nivelin A2.

KUJDES!

- Shtetasi i huaj mund të kërkojë këtë leje qëndrimi edhe për familjarët e tij, duke ndjekur të njëjtat rregulla si bashkimi familjar. Por, në këtë rast duhet të ketë të ardhura më të larta, në fakt të ardhurat minimale rriten me € 2.909,46 për çdo familjar dhe certifikata për kushtet e banesës e lëshuar nga Komuna ose ASL duhet të marrë në konsideratë numrin e familjarëve.
- NUK vlejnë lejet afatshkurtra të qëndrimit dhe lejeqëndrimi për motiv studimi, formimi profesional, qëllime humanitare, mbrojtje të përkohshme ose azil politik.
- Personi NUK duhet të ketë ndenjur jashtë vendit për më shumë se 6 muaj radhazi ose më shumë se 10 muaj gjithsej gjatë periudhës pesëvjeçare të kërkuar të qëndrimit në Itali. Bëjnë përjashtim rastet e shërbimit ushtarak ose të problemeve të rënda të dokumentuara të shëndetit ose të familjes.
- Leja NUK i lëshohet shtetasit që konsiderohet rrezik për rendin publik dhe për sigurinë publike (kushte negative).

SI TË VËRTETOHET NJOHJA E GJUHËS ITALIANE

Në bazë të dekretit të 4 qershorit 2010, shtetasi i huaj që duhet të kryejë provën e gjuhës italiane (niveli A2) duhet të ndjekë këto hapa:

- a. të paraqesë kërkesën e tij nëpërmjet internetit (<http://testitaliano.interno.it>)
- b. të presë përgjigjen me shkrim nga prefektura, e cila duhet të përgjigjet brenda 60 ditëve;
- c. të marrë letrën nga prefektura me datën dhe vendin e zhvillimit të testit të gjuhës italiane;
- d. të paraqitesh në orarin e caktuar për të zhvilluar testin e gjuhës italishte. Duhet të paraqite me një dokument të vlefshëm dhe letrën e thirrjes.



KUJDES!

- Në kërkesë duhet të shkruani saktësisht emrin dhe mbiemrin, adresën e plotë me kodin postar. Nëse gaboni rrezikohet që të mos merrni fletën e njoftimit dhe mund të humbisni provimin.
- Testet zhvillohen pranë CPIA-ve (Qendrat Territoriale të Përhershme për arsimimin e të rriturve).
- Për më shumë informacion drejtoju CPIA-së më të afërt (listen e kurseve në faqen 51).

Nuk duhet ta kryejnë testin

- Të miturit nën 14 vjeç;
- personat me sëmundje të rënda ose me aftësi të kufizuara, të pajisur me vërtetim nga ASL (Agjencia Shëndetësore Lokale);
- personat që zotërojnë një titull jo më të ulët se niveli A2 të Kuadrit Komunitar Europian. Për të qenë të vlefshëm, titujt duhet të jenë lëshuar nga një prej enteve që certifikojnë njohjen në nivel kombëtar (Universiteti për të Huajt në Siena, Universiteti i Perugia, Universiteti i Romës 3, Shoqëria Dante Alighieri) ose nga Qendrat Territoriale të Përhershme për arsimimin e të rriturve (CPIA);
- personat që zotërojnë një diplomë të shkollës tetëvjeçare ose të mesme të marrë pranë një instituti shkollor ose një CPIA-je që i përket sistemit arsimor italian;
- studentët e regjistruar në një Universitet italian, shtetëror, joshetëror ose të njohur ligjërisht; të diplomuarit që bëjnë një doktoraturë ose master universitar në Itali;
- profesorët universitarë, gazetarët dhe përkthyesit.